



## Ndihmoni që të parandalohet zjarri dhe pasojat e zjarrit!

Shumica e zjarreve në shtëpi/banesë parandalohen, nëse ju përmbaheni ca rregullave të rëndësishme:


- Mos i lini qirinjtë e ndezur dhe zjarrin e hapur pa kujdes.
- Mos pini duhan në krevat/shtrat.
- Mos depononi objekte të djegëshme, karroca për fëmijë ose gjëra të ngajshme në shkallët e objektit, në hyrje të podrumit, ngase këto vende janë të preferuara për zjarrëvënës të qëllimshëm.
- Mos punoni pa njohuri vetë nëpër linjat elektrike.
- Mos i mbuloni llampat dhe ngrohësit me ajër me mbulesa. Ngase materialet mund të digjen.
- Shqaroni familjarët tuaj se si ata duhen të sillen në një rast zjarri.
- Mos parkoni në vendkalime të parapara për zjarrëfikësit ose mbi vendet e parapara për zjarrëfikësit.

## Ka zjarr – çfarë të bëjë?

Nëse ka zjarre së pari telefononi zjarrëfikësit nën numrin e emergjencës 112. Nëse ju i njoftoni zjarrëfikësit ata do të arrijnë për pak minuta tek ju.



- Qëndroni në banesë, mos ikni përmes shkallës, ngase kjo mund të jetë vdekjeprurëse.
- Mbylleni derën e banesës, kështu që të mos zgjerohet tymi deri në banesën tuaj.
- Telefononi zjarrëfikësit dhe pritni në dritare ose në ballkon. Atje ju do merrni më lirëshëm ajër dhe do të shiheni nga zjarrëfikësit. Zjarrëfikësit do ju shpëtojnë. Në shumicën e rasteve për këtë përdoren të ashtuquajturat helmëta /kaska shpëtimi. Ato vëhen mbi kokë dhe kanë një filter për frymmarrje. Me anë të këtyre ju mund të merrni ajër edhe në hapësia të tymosura. Zjarrëfikësit me anë të këtyre pajisjeve do ju shpien në mënyrë të sigurt përmes shkallës në hapësirë të hapur. Fëmijët dhe personat e lënduar do të transportohen, nëse ata nuk janë në gjendje për të ecur vet.
- Mos provoni që të zbritni nga dritarja ose të kërceni nga dritarja. Zjarrëfikësit do ju ndihmojnë dhe do ju shpëtojnë.



- Largohuni sa më parë nga banesa dhe vendosni vetën dhe familjarët tuaj në vend të sigurt.
- Gjatë largimit nga banesa mbyllni derën që tymi dhe zjarri të mos shpërndahen më tej. Me anë të kësaj ju e siguron vetës dhe të tjerëve rrugën e ikjes. Merrni me vete çelësin e banesës.
- Mos përdorni ashensorët.
- Njoftoni fqinjët tuaj.
- Telefononi jashtë zjarrëfikësit përmes numrit 112 dhe pritni atje forcat intervenuese.